

H Y L L I

I D R I T Ë S

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas
(II. ad Cor. III 17)

VOTER
KULTURE
SHQIPTARE

5

M A J 1 9 4 4
S H K O D Ë R

HYLLI I DRITËS

E përkohëshme kulturore - letrare e përmuejshme
themelue në vjetin 1913 nga A. GJERGJ FISHTA

Drejtimi dhe mbarështrimi: KUVENDI FRANÇESKAN SHKODËR

PAJTIMI PËR NJI VJETË: në *Shqipni* fr. shq. 30; një numër fr. shq. 4.
Përrjashta fr. shq. 40; një numër fr. shq. 5.

PËRMBAJTJA

Çashtja e elementave fetare në Shqipni <i>P. Anton Harapi</i>	Faqe 1
Analyza Harapiane <i>Mazar Sopoti</i>	» 13
Nga kujtimet a mija <i>L. Bumçi</i>	» 16
Nikolejda <i>Gegë Toska</i>	» 19
Problemet t'ona shëndetsore <i>Dr. Kel Neraçi</i>	» 28
Shenjime demografike të popullit Shqiptar <i>Dr. Injac G. Ndojai</i>	» 37
Fausti <i>Përkëthym nga D. L. Shantoja</i>	» 42
Dokumenta të historisë kombtare - Kongresi i Durrësit	» 54
Fisi si njësi politike: Fisi-Shtet <i>Rrok Zojzi</i>	» 59
Mësimi i gjuhëve klasike në shkollat t'ona <i>Gabriel P. Meksi</i>	» 70
Kundrime shoqnore	» 73

HYLLI I DRITËS

E PËRKOHËSHME KULTURORE - LETRARE

ÇASHTJA E ELEMENTAVET

FETARË NË SHQIPNÍ⁽¹⁾

Zotni të ndershëm,

Më falni për guxim: unë due t'a përballoj çashtjen më delikate në jetën shqiptare.

Kush e kishte zanë besë?... Antagonizmi fetar qiti kryet dhe mizorisht u fut edhe ndër atheistat e ditës. Egërsit e bame në Jug, midis djelmnis shqiptare, vetëm pse muhamedanë e kristjanë, janë fakte qi nuk lënë me luejtë, por janë edhe prova të tmerrshme për jetën t'onë fetare, shoqnore e kombtare.

Për sa dij unë deri më sod, kjo çashtje kurr nuk qe përballue kjartë e mirë; sa herë qe kallë, menjherë edhe qe mbulue porsì gaca në hi. T'i mbetet hatri kuj të duejë, unë due t'a thom mendimin t'ëm haptas. Marrë në shumicë *muhamedani shqiptar është fanatik, orthodoxi fanatik, katholiku*

(1) Kjo është ligjërata qi Shkëlqesa P. Anton Harapi mbajti në Kinema-Theatër «Kosova» para një publiku të zgjedhun me 14 maj 1944 për të dhanë një kontribut për vllazënt e damtuem të Jugut dhe për të ndriçue popullin mbi një problem themeluer për *bashkim e vllazni të të gjithë Shqiptarvet*. Tema randsi-plotë e zhvillueme me objektivitet e kompetencë dhe me gojtarin e njoftun të këtij pionjeri të Shqiptarizmës korri suksesin më të plotë tue i prì një hap përpara nivelit të jetës shoqnore-fetare në Shqipni.

SHËHIM I REDAKSIS



fanatik, e këta jo aq për besim, sa për inat e për parti. Ndër çasat më të vështirë të jetës s' onë kombtare, njimend se shpëtues format e bashkimit shoqëror e të qetsisë ndër elementa, porse në fund të punës mbeti një tharm, një fond rryme e partije fetare, sa me të trembë e me të demoralizue.

Tue prekë me dorë plagën, vjen pyetja: A do të mund të rrojnë, e si do të mund të rrojnë në qetsi tre elementat fetarë ndër né?

Atheistat me të gjithë skeptikët, indiferentat, naturalistat, aventurjerët e oportunistat, thonë se jo: na shqiptarët nuk mund të rrojmë të qetë, as nuk mund të formojmë shtet, për pa i zhdukë të gjitha besimet, pse « *besimi i shqiptarit është shqiptarizma!* ».

Këta shpresoj t' i përballoj një herë tjetër; këtyne tash po u thom vetëm se Shqipëria nuk është *vend i pa Zot*; e shqiptarët as nuk janë, as nuk duen të jenë të *patënzonë*.

Fjalën këtë herë e kam me besimtarët e tre elementave.

Pa kontestim na jemi një komb, një shtet e një popull me një shpirt, me një gjuhë e me një histori, e po t' ishëm edhe të njëjti besimi, patëm me qënë më të bashkuem, më homogjenë; dhe as nuk patëm me bjerrë mënd e kohë për t' u kuptue ndër shumë punë. Por fakti është ky, se na jemi, pra, muslimanë, orthodoxë e katolikë, e si të tillë duem të rrojmë në një harmoni vllaznore. Unë thom se për këtë punë nuk është nevoja me shue besimet, pse po të duem, mund të rrojmë vllaznisht, sikurse kemi shembullim ndër sa shtete të tjera të qytetnueme.

Pra, thezim t' em e vë këso dore: shqiptarët po qënë vertë të qytetnuem e nacionalista të sigurtë, besuen edhe përnjimend në një Zot të vërtetë, nuk kanë se si mos të rrojnë vllaznisht shoq me shoq; përkundrazi, deri sa mos të kenë *kulturën njerzore në shpirt, ndëryjegjë të kolektive kombtare*, deri sa t' u mungojë *kultura fetare*, ata kanë me qënë të dëm e të përçam jo pse janë tri besimesh, por pse nuk kanë bazat e jetës shoqërore, kombtare e fetare.

Pëngimi i madh për jetën shoqërore, pra, për qetsinë e vllaznimin t' onë është *fanatizmi*, i cili është një turp për vehtjen, turp për besimin të cilit i përket vehtja e turp për jetën shqiptare. Besimi që mbahet për pasjon, pra me fanatizëm, nuk është besim i arsyeshëm as faktor i jetës; ai nuk nallon por poshtnon, e më tepër rrenon se sa trajton. Besimi në një Zot të vërtetë, Ati i të gjithë njerëzvet, nuk do t' a shtojë antagonizmin, por do t' a hjekë, a nemosë do t' a pakësojë; besimi do t' a zbusë njerin ndër ndiesi e jo t' a egërsojë, do t' i rregullojë prirjet e instinktit ndër të cilat është edhe egoizmi vehtjak e kolektiv. Dhe siguroj me krye se nuk është besimi ai që të bën me mëni shqiptarin, por është egoizmi që don të justifikohet me shkakun e besimit.

Këtu është nevoja t' a dalloj njerin fanatik nga njeriu me karakter: të

